KUVENDI
NR 367 DATE 29.01.20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

Nr___Prot

Tiranë më 29.01.2020

**Drejtuar:** Z. Gramoz Ruçi
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

**Lënda:** Kërkesë për interpelancë urgjente me Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, Z.Blendi Klosi

**Baza Ligjore:** Rregullorja e Kuvendit të Shipërisë, neni 97 i saj, "Interpelancat urgjente"

**Këtu**

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 97 të Rregullores së Kuvendit, një grup prej 7 deputetësh paraqesim kërkesën për interpelancë urgjente me Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, Z.Blendi Klosi.

Objekti i interpelancës është:

Kërkojmë shpjegim lidhur me dëmtimet serioze të sipërfaqeve të mëdha pyjore halore në rrethin e Korçës, Kolonjës, Pukës, Mirditës, Peshkopisë nga Procesionaria shkatërruesja e tyre e pamëshirshme, e cila ka tharë me mijëra pisha e rrezikon mijëra të tjera. Për rrjedhojë kjo gjendje ka dëmtuar ekosistemin pyjor, mjedisin e turizmin në këto zona.

A e njeh nga afër situatën Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe si paraqitet ajo në shifra, konstatime e të dhëna konkrete?

A nuk dëshmon kjo gjendje se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka dështuar në këtë aspekt në qeverisjen shtatë vjeçare?

A ka menduar e planifikuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, masa, programe apo projekte konkrete për të përballuar këtë situatë katastrofike në pyjet halore?

Mbetemi në pritje të caktimit të datës së zhvillimit të interpelancës urgjente, në përputhje me afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe Rregulloren e Kuvendit.

**Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.**

**Deputetët kërkues**

1. LIGORAQ KARAMELO
2. VASIL STERJOVSKI
3. Ilirjan Gjozi
4. Zef
5. Mirlinda Halilaj
6. Edlira Braka
7.